POSTIM ARKIVOR

# Rexhep Mitrovica (1888 - 1967)




SEKSIONI

Figura historike

PERIUDHA

1961 - 1967

Rexhep Mitrovica, veprimtar i çështjes kombëtare, nënshkrues i Aktit të Pavarësisë më 1912, ministër i Arsimit dhe kryeministër i Shqipërisë gjatë një periudhe të vështirë të Luftës së Dytë Botërore (1943–1944). Me gjithë kontributin e dhënë në Kosovë kundër forcave çetnike serbe, shpëtimin e hebrenjve dhe romëve nga deportimi, mbrojtjen e kufirit verior, ai u cilësua nga Qeveria e pasluftës "Kolaboracionist" për shak të zgjedhjes së e tij më 16 tetor 1943, nga Kuvendi Kombëtar në Tiranë, anëtar i Këshillit të Lartë të Regjencës, dhe më 5 nëntor të po atij viti, Kryeministër i Shqipërisë.

PERMBAJTJE #1

# Një ish-kryeministër nën syrin e Sigurimit të Shtetit

Dosja formulare përmban dokumentacion të mbledhur nga ish-Sigurimi i Shtetit për Rexhep Mitrovicën (18 janar 1888 - 21 maj 1967), ish-Kryeministër në vitin 1943. Përmban informata që i përkasin qëndrimit të tij në Turqi (Stamboll) për periudhën 1961-1967, plane masash të Sigurimit të Shtetit për ta takuar dhe marrë informacione, 10 foto dhe artikuj të gazetës Mundimi (1944) dhe “Flamuri” (1953).

MEDIA #1

# Dosje formulare nr. 331

MEDIA FAQE #1




Dosje formulare nr. 331

INFORMACION

## Dosje formulare nr. 331

Autoret: Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Sigurimit të Shtetit

| | |
|---|---|
| FONDI | Të arratisurit |
| KUTIA | 09 |
| DOSJA | nr. 332 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Dosje formulare |
| VITET EKSTREME | 1961-1967 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

# Pa titull

MEDIA FAQE #1



" Rapi " Nr. 0471: Ne Qender ndodhen materiale qe flasin per te kaluaren dhe qendrimin e mevonshem te ketij kandidati. Vlefshmenija qe paraqet kandidati eshte e madhe, por jane te pakta mundesite per venien e tij ne sherbimin tone. Pervec aresyeve te tjera, mendojme se ne kete drejtim duhet te jete pengese edhe mosha, i cili duhet te kete kaluar te 70 vjetet.

Megjithate, qendrimi qe ay ka mbajtur keto kohet e fundit dhe situata aktuale, jane pozitive dhe na favorizojne per te marre kontakt dhe per te vepruar ne drejtim te tij. Ne fillim tek ky person duhet shkuar me qellim per ta afruar dhe per ta çfrytezuar si mik ne interes te Atdheut dhe Kosoves. Pastaj do te shikohen mundesite e tjera per venien e tij ne sherbimin tone, per te cilen, si u tha me siper, nuk kemi shume shpresa qe te behet gje. Sidoqofte, per neve ka interes edhe per ta mbajtur dhe çfrytezuar si " mik " personal. Ne drejtim te ketij kandidati do te meren masat operative si me poshte:

I.- Brenda 3 mujorit te pare do te merret kontakt, duke i shkuar ne befasi ne qendren e punes ne Stamboll. Ne kete takim do te trajtohen keto ceshtje:

a.- Do te bisedohet lidhur me situaten dhe me kete rast do i behet sqarimi i nevojshem mbi gjendjen e marredhenieve tona me udheheqjen e Bashkimit Sovjetik, mbi realizimet dhe suksesët qe jane aritur ne Shqiperi, etjera.

b.- Pastaj do te bisedohet per ceshtjen e Kosoves, duke i folur me kete rast per gjendjen e mjerushme te " Atdhetareve " ndene " Blozen ", mbi veprimet dhe qendrimin armiqesor te " Blozakeve ndaj pakicave " Atdhetare " atje dhe kundra vendit tone, mbi politiken e çkombetarizimit qe ndjekin " Blozaket " ne drejtim te " Atdhetareve ", mbi qendrimin e Qeverise tone per ceshtjen e "Atdheut", me kete rast edhe mbi detyrat qe ju dalin "Atdhetareve" ne kete drejtim, etjera.

c.- Ne rastin oportun mund te hyhet ne bisedim edhe per ceshtjen e " Lidhjes Kosovare ", duke e pyetur ate mbi programin e saj, mbi veprimet e deritashme dhe pastaj, duke i folur edhe ne kete drejtim, por gjithemon me takt, sepse sic dihet i biri i tij eshte kryetar i kesaj te ashtuquajtur organizate.

ç.- Gjithashtu, mund ti kerkohet gjoja ndihme lidhur me dokumentat e vjetra qe ndodhen ne biblotekat e Stambollit, kjo me qellim per ti dhene rast

AIDSSH Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

Pa titull

MEDIA FAQE #2



- 2 -

etij qe te na flase mbi dokumentat qe ka grumbulluar ay dhe per shtenien e tyre ne dore, te cilat mendojme se do te jene edhe mjeti per te vazhduar marredheniet me te, natyrisht ne rast se do te tregohet i gatshem per te na sherbyer ne kete drejtim.

2.- Gjate ketij takimi, do te studjohet qendrimi i kandidatit dhe mundesite e tija per qellimin qe u tha me siper. Mbas ketij takimi, ne rastin pozitiv, do ju dergohet pllani i masave operative per te ardhmen.

Lidhje e p.op. " Devolli "

DUHET PATUR PARASYSH
SE KY ESHTE NJE NGA KRIMINELET
QE KA PATUR POZITEN ME TE LARTE
GJATE OKUPACJONIT. PRANDAJ NUK
MUND TI SHKOJME DIREKT NE TA-
KIM E TI KERKOJME TE BEHET
"MIKU" TONE. TI SHKOJME NE VENDIN
E PUNES KU SHET BENZINE SI NE
KALIM DHE KESHTU TAKIMI E BISE-
DA TE BEHEN SI TE RASTIT. TE SHI-
FET QENDRIMI E TE VEPROHET NE
KONSEGUENCE.

Janar 1962

Pa titull

INFORMACION

## Pa titull

Autoret: Punëtori operativ "Devolli"

| | |
|---|---|
| FONDI | Të arratisurit |
| STRUKTURA | Drejtoria "Zbulimi" |
| DOSJA | Nr. 332 |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| VITET EKSTREME | 1961-1967 |
| DATA E KRIJIMIT | Janar 1962 |
| NR. I FLETEVE | 2 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

# Propozim

MEDIA FAQE #1



APROVOHET
MINISTRI PUNEVE MBRENDESHME
GJENERAL-LEITNANT
(KADRI HAZBIU)

Teper Sekret
Tirane me I/IV/1963

Date__________

**PROPOZIM**
**PER TE MARRE TAKIM ME REXHEP MITROVICEN NE TURQI**

E kaluara e keqe e tij dihet - gjate okupacionit arriti te behesh kryeminister ne nje nga qeverite kuislinge te krijuara nga gjermanet. Aktualisht ndodhet ne Turqi (Stamboll). Nga gjendja ekonomike nuk eshte mire, ka nje pune te vogel - shet benzine.

Ka aderuar ne "Ballin Agrar" te Abaz Ermenjit, po keshtu dhe biri i tij Nexhati, i cili eshte aktiv mjaft ne "Lidhjen Kosovare" qe drejtohet nga "agraret".

Nga nje seri burimesh, rezulton se Rexhep Mitrovica eshte ftohur nga "agraret", shkon keq sidomos me pergjegjesin e "agrareve" ne Turqi - Qazim Prodanin, ka çfaqur pa kenaqesi per politiken qe ndjekin " agraret" lidhur me Kosoven duke thene se mua nuk me intereson lufta kunder Republikes Popullore te Shqiperise sepse kjo ekziston si shtet me vehte dhe njihet, por lufta kunder Jugosllavise per çlirimin e Kosoves. Mbas prishjes se marredhenieve me grupin e Hrushovit, ka folur gjithenje mire per qendrimin e Partise dhe Qeverise tone.

Duke marre parasysh qendrimin e me siperm te tij, propozojme ta takojme. Nuk eshte fjala per ta rekurtuar agjent, por per te biseduar me te mbi Shqiperine e Kosoven, per ta bindur qe Partia e Qeveria e jone jane mbrojtese te verteta te interesave te Shqiperise dhe te Kosoves, te bisedohen çeshtjet qe eshte pro nesh e t'i perforcohen ato duke synuar qe t'arrijme te kemi kontakte

% % %

Propozim

MEDIA FAQE #2



-2-

te here pas hereshme, sigurisht te fshehta dhe ta çfrytezojme ne tym per t'i marre te dhena. Ne keto takime te synohet ne keto drejtime:

1.- Duke demaskuar veprimtarine e jugosllaveve kunder vendit tone dhe per shtypjen e Kosoves, te mundim te marrim prej tij ç'ka na intereson lidhur me kete veprimtari e te perpiqemi ta aktivizojme sa te jete e mundur kundra jugosllaveve.

2.- Duke demaskuar kreret tradhetare te organizatave reaksionare si njeres te shitur tek te huajt dhe qe zhvillojne veprimtari ne kundershtim me interesat e Atdheut, te marrim prej tij ç'ka mund te dije ne kete drejtim.

3.- Duke çfrytezuar grindjet qe ekzistojne midis ketij dhe krereve reaksionare te tjere, te perfitojme per shtimin e kontradiktave ne emigracion.

4.- Te perpiqemi te marrim ato dokumenta me karakter historik mbi Shqiperine e Kosoven qe thuhet se i disponon.

Takimin mendojme ta beje "Neptuni" si gjoja rastesisht.

Lutemi, ne se jeni dakord, aprovoheni.

DREJTORI DREJTORISE I-re
GJENERAL-MAJOR
(ZOI THEMELI)

AIDSSH Nr. 67 Prot Date 29.01.2026

Propozim

INFORMACION

## Propozim

Autoret: Zoi Themeli, drejtor i Drejtorisë I

| | |
|---|---|
| FONDI | Të arratisurit |
| TIPOLOGJIA E DOSJES | Formulare |
| DOSJA | 331 |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Turqi, Egjipt |
| GJUHA | shqip |
| VITET EKSTREME | 1961-1967 |
| DATA E KRIJIMIT | 1.4.1963 |
| NIVELI I KLASIFIKIMIT | Tepër sekret |
| NR. I FLETEVE | 2 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

# Pozitë

MEDIA FAQE #1



Nr. B-6

Teper Sekret
Dt.8/V/1963

"VENUSIT"

POZITE

Aprovejme qe me "0471"(Rapi) te merrmi nje kontakt.Me qene se nga ana e prestigjit shteteror nuk eshte mire ta takoje "Venusi",kontaktet me të të merren prej "Neptunit".Takimi te legjendohet mire dhe t'i jepet pa tjeter karakter i rastit - "Neptuni" ne fillim te tregohet sikur ka vajtur rastesisht (per te marre benzine) tek vendi i punes i "0471"-shit,gjoja pa e ditur se kush eshte atje,per pas prezantimit me te te pranoje te bisedoje me te si shqiptar dhe takimi te paraqitet si veprim thjeshtesisht personal.

Gjate ketij takimi me te te bisedohet ne vijat qe kini parashikuar ne planin t'uaj.Duke hyre ne bisedime me karakter kombetar me të te synohet qe:

a) Duke demaskuar veprimtarine e "blezakeve" kundra vendit tone dhe "Atdheut",te mundemi te merrmi prej tij ç'ka na intereson lidhur me kete veprimtari e te perpiqemi ta aktivizomi sa te jete e mundur kundra "blezakeve".

b) Duke demaskuar kreret e organizatave tradhetare te emigracionit reaksionar si njeres te shitur tek te huajt dhe qe zhvillojne veprimtari ne kundershtim me interesat e Atdheut,te merrmi prej tij ç'ka mund te dije ne kete drejtim.

c) Duke çfrytezuar grindjet qe ekzistojne midis ketij dhe krereve reaksionare te tjere,te perfitojme per shtimin e kontradiktave ne emigracion.

ç) Te perpiqemi te merrmi ato dokumenta me karakter historik mbi Shqiperine dhe Kosoven qe thuhet se i disponon.

Ne vartesi me si do reagoje ne takimin e pare,mund te lini shteg per ta takuar perseri por pa caktuar qe me pare takim me te, d.m.th.qe edhe takimet e mepastajme me te te behen ne befasi.Manovromi me kujdes qe ai te mbaje sekretin per kete takime.

Na njoftomi perfundimin e veprimit.

"MIFOLI"

Pozitë

INFORMACION

## Pozitë

| | |
|---|---|
| DATA E KRIJIMIT | 8.5.1963 |
| NIVELI I KLASIFIKIMIT | Tepër sekret |
| NR. I FLETEVE | 1 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #5

# Informatë

MEDIA FAQE #1



26

Informate:

Per çeshtjen e Kosoves:Me tregoi prapambetjen e kosovareve ne te kaluaren dhe perparimet qe jane bere gjate vjeteve te fundit sidomos ne sektoret e kultures dhe arsimit dhe populli tani eshte zgjuar,sidomos rinia.Kudo ka shkolla shqipe dhe me arsimtare shqiptare.Ne kete drejtim,tha Mitrovica,ka kontribuar shume edhe Shqiperia,sidomos ne vitet e para te mbas luftes.Populli i Kosoves ka luftuar dhe perpiqet gjithemone per bashkimin e Kosoves me Shqiperine.Kjo ka qene edhe eshte deshira e tyre,por per fat te keq nuk eshte realizuar deshira e tyre.Çeshtja e Kosoves eshte e pa zgjidhur sot per sot dhe shume e komplikuar,kete çeshtje mund ta zgjidhe vetem nje lufte e trete dhe çdo gje dipendohet nga Qeveria Shqiptare.Neve perjashta jemi perpjekur dhe perpiqemi per te mbajtur afer kosovaret qe ndodhen ketej,per te mbajtur ngritur çeshtjen e Kosoves dhe per te mbrojtur te drejtat e tyre ne boten e jashteme.Per kete qellim eshte formuar edhe "Perpjekja Kosovare",e cila ne mbledhjet e ndryshme nderkombetare qe jane bere deri me sot,ka ngritur çeshtjen e Kosoves dhe ka kerkuar te drejtat e saja.Ky ka qene dhe eshte qellimi i "Perpjekjes Kosovare".

Nxjere nga burrimi nr.484 dt.25/II/1961

Nxori kap.J.Preko

Shënim

Biseda është bërë me Rexhep Mitrovicën.

Informatë

INFORMACION

## Informatë

Autoret: Burimi 484

| | |
|---|---|
| DATA E KRIJIMIT | 25.2.1961 |
| LLOJI I DOKUMENTIT | Informatë |
| NR. I FLETEVE | 1 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

# Plan veprimi

MEDIA FAQE #1



Nr.B-1

TEPER SEKRET

173

PLLAN VEPRIMI NE DREJTIM TE "RAPIT"

Sic dihet,ky eshte nje nga te paktet "krere" te emigracjonit reaksjonar qe gjendet ne "Qabe".Prej kohesh eshte terhequr pothuajse fare nga aktiviteti "politik" me gjithse lidhjet i ruan akoma me kreret e "Ballit Agrar" te Abaz Ermenit e sidomos me kete vete,kurse djali i tij,Nexhat Mitrovica qe banon ne Paris zhvillon aktivitet Ballist si kryetar i "Lidhjes Kosovare" qe,sic dihet,eshte pjelle e "Komitet Demokratik Shq.Lire" e Parisit.Ftohja e "Rapit" me Ballin,me gjithse eshte shkaktuar me shume nga prishja e maredhenjeve te tij me Qazim Prodanin sidomos keto vitet e fundit,ka nje kuptim me te gjere lidhur me konsideraten e tij per ate "Parti".Dihet se "Rapi" ne fillim keshillonte Qazimin qe te ishte me i matur ne qendrimin dhe aktivitetin e tij si kundra Shqiptareve te Kollonise qe raportonte ne Polici si komuniste ose te lidhur me Legaten ashtu dhe ne shkrimet e gazetes "Besa".Por Qazimi vazhdonte ne te tine dhe keshtu "Rapi" shkeputi cdo lidhje me gazeten "Besa",jo vetem duke mos shkruar me ne te por edhe duke e kritikuar ate dhe vete Qazimin.Tani,maredhenjet e tyre nuk jane aspak te mira aqe sa,i influencuar "Rapi" indirekt edhe nga disa burime tona,e ka raportuar Qazimin te Abaz Ermeni per ceshtjet e me siperme.Tani,sipas te dhenave te fundit,maredhenjet e tij me Ballin dhe personalisht me Abaz Ermenin jane ne nje gjendje akoma me te keqe per shkak te ankesave te Nexhat Mitrovices,i cili ka njoftuar "Rapin" se Abazi nuk ka bere aqe sa duhet perpjekje qe te njifet nga Amerikanet "Lidhja Kosovare" si nje organizate e vecante nga Balli Kombetar dhe Komiteti i Parisit.Kejo tregon se kane filluar ferkime midis Nexhatit dhe Abazit,kurse sipas te dhenave tona "Rapi" ka mbajtur dhe po mban anen e Nexhatit.Eshte interesante arsyetimi qe ben "Rapi" kur mban anen e Nexhatit ose me mire te "Lidhjes Kosovare" te cilen ja ka shkrojtur hapur edhe vete Abaz Ermenit.Ay thote se "Lidhja Kosovare" duhet te njifet nga anglo-amerikanet si nje organizate

9-3-63

%

Plan veprimi

MEDIA FAQE #2



-2-

174

me vehte dhe jo si pjese e Ballit Agrar,sepse "Lidhja Kosovare" eshte krijuar per te luftuar per ceshtjen e Kosoves qe vuan nen okupacjonin e te huajve,kurse "Balli Agrar" eshte nje parti politike qe kerkon te interesohet per probleme te Shqiperise,e cila ne fakt sot egziston si shtet me vehte,e njojtur boterisht.Duke njojtur neve qendrimin e "Rapit" ne drejtim te vendit tone,sidomos ky qysh nga prishja e maredhenjeve me kliken krushovjane,i cili kurdohere eshte shprehur mire,keto argumenta te "Rapit" marin nje kuptim me te thelle dhe,me te drejte neve duhet ti interpretojme se ay don te thote:Mua me intereson lufta qe duhet bere kundra Jugosllavise,dhe aspak ajo kundra regjimit ne Shqiperi,prandaj ne kete drejtim duhen bashkuar forcat dhe jo per te kunderten.Te tilla mendime "Rapi" i ka cfaqur hapur para nje sere burimesh tona,dhe ay ka shkuar edhe me tej duke lavderuar qendrimin Patriotik te udheheqjes tone,sidomos ne ceshtjet e mbrojtjes se interesave kombetare kundra synimeve te armiqve,ne radhe te pare te Jugosllaveve e grekeve.Si njeri i zgjuar qe eshte,ay ka kuptuar se Shqiperija dhe Ceshtja e Kosoves nuk mund te presi asgje te mire nga shtetet e Perendimit;dhe se emigracjoni reaksjonar dhe vete Balli Agrar dote jene te gatshem te bashkohen edhe me dreqin per ambicjet e tyre te caktuara dhe per lufte kundra vendit tone.Ne kete gjendje shpirterore ndodhet "Rapi" sot.Nga kejo,neve mund te nxjerim nanje fare perfitimi.

Prandaj neve mendojme se ne kete situate vlen qe ta takojme.Per shkak te moshes tij dhe vete mentalitetit,e kemi veshtire te shpresojme per ta vene ate ne bashkepunim mbi baza agjenturale.Por neve shpresojme shume se nga nje kontakt direkt me te,mund ti bejme nje perpunim te mire me pikesynime:

a-Ti perforcojme dhe tja bejeme akoma me te kjarta pikepamjet e tij pozitive mbi vendin tone,duke ja forcuar bindjen se cdo veprim kundra pushtetit tone demton interesat e Popullit,te kombit dhe te vete ceshtjes se Kosoves.

%

Plan veprimi

MEDIA FAQE #3



-3- 80/ 175

b-Ta bindim nje here e pergjithmone se nga shtetet perendimore dhe nga vete Amerika e Inglitera nuk mundte pritet asgje e mire as per Shqiperine dhe as per Kosoven,dhe per kete kemi argumenta historike dhe aktuale te bolleshme.

c-Mbeshtetur e duke shfrytezuar edhe pikepamjet e tij,ta bindim mbi rolin anti-kombetar qe lozin grupet reaksjonare ne emigracjon,per fshi edhe "Ballin Agrar",me perpjekjet e tyre kundra vendit tone,te drejtuara nga shtetet e huaja qe nuk ja duan te miren Shqiperise dhe bejne interesat e fqinjeve armiq te vendit tone.Ti bejme presjon me kete rast per ti forcuar bindjen ose te pakten dyshimin qe shume krere reaksjonare,ashtu sidhe ne te kaluaren,tani jane edhe ne bashkepunim me kliken Titiste duke u bere keshtu edhe vegel e kesaj klike per qellimet e njojtura kundra Shqiperise.Ne kete menyre,te perpiqemi ta bejme ate qe ti neveriten akoma me shume grupet dhe kreret reaksjonare.Per tja forcuar kete bindje,ti japim shembell drejtimin qe i kane dhene e dote duan ti japin akoma me shume ne te ardheshmen "Lidhjes Kosovare" dhe cfare ka bere,ose me mire nuk e kane lejuar te beje ajo lidhur me qellimin per te cilen eshte krijuar.

ç-Gjithe synimi tone te konsistoje qe ay te kuptoje se vetem Qeverija tone mbron interesat e verteta te vendit dhe te Kosoves,dhe se po te kete edhe nje fije dashurije per Kosoven duhet te dije me luftu per te ne rruge te drejte e jo ashtu si deri sot kur kishte varur me kot shpresat te "Balli Agrar" ose grupet e tjera ose me ne fund edhe tek te huajt.Ne kete menyre,ta veme perpara detyres qe te angazhohet qe te luftoje veprimet e armiqve,sidomos ato qe synojne per te perdorur kosovaret qe gjinden jashte ne veprime te mundeshme kundra vendit tone.Vec kesaj,ta bejme qe te na flasi mbi sa din lidhur me keto veprime,te angazhohet per ti zbuluar e per te na i njoftuar dhe, sipas situates qe do paraqitet ta nxitim mund te avancohet edhe me tej,sidomos duke e nxitur qe te influencoje ne percarjen e me tejeshme te grupeve tradhetare,ne radhe te pare te "Lidhjes Kosovare" me "Ballin Agrar".Per shkak te pretendimeve qe ay mund te kete,takimin ta beje "Venusi",brenda muajit shkurt-Mars 1963.

"V e n u s i"
Ven

Shif prapa ./.

Plan veprimi

MEDIA FAQE #4



Kleanth

- Per Rapin kemi nje seri te dhenash qe pak a shume jane pozitive. Te shikohen te gjitha keto dhe te permblidhen keto. Te nxjerren dhe anet negative te tije.

- Jam dakord qe me pozitat qe eshte ay duhet te takohet, por jo per te vene ne sherbimin tone si agjent – kete nuk mund te ia arrijme. Te takohet per te biseduar lidhur me mbrojtjen e atdheut – Shqiperise dhe Kosoves nga armiqet, per ta bindur ate se vetem Qeveria e R.P. te Shqiperise eshte mbrojtesja e vertete e interesave te Shqiperise dhe te Kosoves. [illegible] qe te kemi me te kontakte te here pas hershme (sigurisht te fshehta) dhe gjate bisedave me e shfrytezuar

- Me qene se ka qene person me pozite te madhe ne te kaluaren, duhet te [illegible] aprovimi i Ministrit per takimin me te, prandaj sa me shpejt te behet raport propozimi. Ne kete te paraqitet shkurt c'eshte Rapi, sidomos qendrimi qe ay mbane ne kohen e [illegible], se eshte e pershtatshme qe ta takojme jo per ta vene ne marredhenje agjenturale, por ne fillim per ti forcuar bindjen se vetem Qeveria e R.P. te Shqiperise eshte mbrojtesja e vertete e interesave te Shqiperise dhe Kosoves, me kujdes ceshtje qe ay eshte dakord me ne ose afer nesh, me e shpjeguar se ku kane perfunduar organizatat e emigracionit reaksionar (agjentura te zbulimeve imperialiste), me treguar [illegible] e Kosoves – se Lidhja Kosovare i sherben tani armiqeve, se e tille eshte dhe "Lidhja e Prizrenit" qe u krijua se fundi etj. etj. Takimin dakord ta beje Venusi.

Bejeni shpejt e mire.

[signature]
20.3.63

Plan veprimi

INFORMACION

## Plan veprimi

Autoret: "Venusi"

| | |
|---|---|
| LLOJI I DOKUMENTIT | Plan veprimi |
| NR. | B-1 |
| NIVELI I KLASIFIKIMIT | Tepër sekret |
| DATA E KRIJIMIT | 9.3.1963 |
| NR. I FLETEVE | 4 |
| KRIJUAR NGA | "Venusi" |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #7

# Informatë

MEDIA FAQE #1



75-M-EM.

30

34

INFORMACION

Nga nje burimi jone ne Turqi informohemi:

Rexhep Mitrovica eshte treguar i kenaqur qe nuk eshte goditur nga ana e jone si kriminelet e tjere.Ay ka treguar se ish ministri amerikan ne Shqiperi i dergonte shume te falura me anen e djalit te tij i quajtur Nexhat Mitrovica qe tani ndodhet ne Paris.Kjo duhet te kete qellim per ta aktivizuar ate,por ay ka thene se me asgje nuk do te ngaterohet e se do te keshilloje edhe djalin kur te veje ne Turqi per pushime.Duke folur per qeverine tone Rexhepi ka thene se ajo mire punon per vehte dhe Kosoven,por per kete te fundit nuk arrihet dot asgje.Do te ishte mire,ka thene ay,qe te mos acarohet me emigracionin politik qe ndodhet perjashta,perkundrazi duhet ta kete mire qe emigracioni te influencoje ne interes te Kosoves prane qeverive perendimore,ndersa qeveria te demaskoje fqinjet per mbrojtjen e saj.Kur nje shqiptar ka reaguar per sa tha Mitrovica duke e cilesuar ate si nje kompromis,por dihet qe udheheqesit shqiptare kete gje nuk e kane pranuar me te drejte qysh gjate luftes,Rexhepi ka pranuar,por tha se atehere per Kosoven mbetet ta zgjidhe problemin lufta e trete po u be.

Burim i pa sprovuar.

Nxori Kap.J.Proko
Dt.22/VII/1963

Zv.SHEFI SEKSIONIT EMIGRACIONIT
M A J O R
(ROPI LLAZI)

Informatë

INFORMACION

## Informatë

| | |
|---|---|
| DATA E KRIJIMIT | 22.7.1963 |
| BURIMI | I pasprovuar |
| HAPËSIRA GJEOGRAFIKE E VEPRIMTARISË | Turqi |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #8

# Foto

MEDIA FAQE #1




Foto

INFORMACION

## Foto

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

# Foto

MEDIA FAQE #1



Mbretnija Shqiptare
Kryesija e Këshillit të Ministravet

KONCEPT 19/8 Res. (piani dt. 19/15)

Tiranë, me 23/vi/944

REZERVATE

67

P.T.
KRYESIS SË KËSHILLIT TË NALTË
TIRANË

Nga informata qi na japin persona të besueshëm qi vinë nga Kosova, rezulton se personat e burgosun nga ana e Policis ushtarake gjermane në ato vise, ndër ta edhe funksjonarë të naltë të Shtetit janë përqëndrue në Prishtinë edhe përdoren pa dallime pozite shoqnore ose idee politike shum keq nga ana e autoriteteve që i ruajnë. Informatat më thonë se funksjonarë të naltë të Shtetit përdoren tue tërheqë karocat ushtarake gjermane në për mes të rrugave kryesore të Prishtinës për të bartun, nga periferit' e qytetit, gadi deri më 7 Km. largësi prej orës 7 të mëngjezit deri më orën 7 të mbramjes, të reckosun dhe gadi zbathë, patate dhe sende të tjera për nevojat e ushtërisë gjermane.

Nuk asht nevoja t'Ju theksoj se në çfar pozitë ndodhet jo vetëm prestigji personal i atij nënpunsi të naltë të Shtetit por edhe prestigji i vetë Shtetit Shqiptar, përpara këtyne mënyrave veprimi.

Prandaj, tue marrë parasysh se Shkelqesija e Juaj jeni në kontakt direkt me Gjeneral Fitztumin, Ju lutemi që sa ma shpejt me autoritetin t'Uej të ndërhyni pranë tij që të pushohet çdo masë e marrun në kundërshtim me dinjitetin dhe me prestigjin e Shtetit Shqiptar dhe të normalizohet nji gjendje që po vazhdon prej disa kohësh.

Me nderime.

KRYEMINISTRI
R. Mitrovica

Foto

INFORMACION

## Foto

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.